

SPECIFIKIME TEKNIKE

(MBI ZBATIMIN E PROJEKTIT)

MBI NDERTIMIN E OBJEKTIT:

“Rikonstruksoni i urës së fshatit Vilëz, Zall Bastar”

VENDI NDERTIMIT

KOMUNA ZALL BASTAR BASHKIA TIRANE

Konstruktor relatues :

Ing. Albert Sharra

License K-0829/1

“Rikonstruksoni i urës së fshatit Vilëz, Zall Bastar”

VENDI NDERTIMIT:

Njesia administrative Zall Bastar ,Bashkia – TIRANE

Objekti **“Rikonstruksoni i urës së fshatit Vilëz, Zall Bastar”**, e cila ndodhet ne njesine administrative Zall Bastar te bashkise Tirane, me investitor Drejtoria e Puneve publike, te bashkise Tirane.

A. Objekti perfshin keto elemente kryesore per rikonstrukson.

1. Ndertimin e lidhjes se dy aneve te ures ekzistuese, me brigjet , per zhvillimin normal, te levizjes se mjeteve dhe nerezve , ne dy anet e lumit.
2. Ndertimi I kesaj shtese ne dy anet e lumit me uren ekzistuese ne mes nepermjet nje ndertimi me kosto sa me optimale dhe te shpejte ne kohe, per ta vene ne shfrytezim.
3. Zhvillimin e zgjidhjes nepermjet verifikimit ne terren te situates, dhe percaktimin e elementeve te domosdoshem ne zgjidhjen e saj si:
 - a. Rilevimin faktik topografik te dy aneve te ures dhe te vete ures
 - b. Hartimin e nje studimi gjeologjik, te zones se marre ne studim, te ures dhe dy aneve te saj ku do te kalonte shtesa e ures
 - c. Hartimin e nje projekti, ne perputhje me zhvillimin per nje kohe te gjate te kesaj vepre,si dhe koston sa me te pranueshme per ndertimin e saj.



B. Nga hartimi I projektit ne zhvillimin e saj objekti ka dhe specifikat dhe masat qe duhen marre ne ndertimin , sa me korrekt te kesaj vepre:

1. Para fillimit te punimeve te kontrollohet zona qe duhet germuar deri ne tabanin e murit gabion, sipas kuotes se dhene ne projekt Ne rast se zonat ne te dy anet e ures, kane nivel te larte te ujrave te lumit, eshte mire te behet devijimi I ujrave te tij nga njera ane , per te lejuar zhvillimin e punimeve , ne zonen e devijuar, dhe me mbarimin e saj te behet , e njejta gje ne anen tjeter.
2. Germimi, dhe nivelimi I bazamentit per vendosjen e murit gabion, te jete ne perputhje me studimin gjeologjik te bere per kete object, dhe para fillimit te punimeve te thirret gjeologu dhe ing. Konstruktore I projektit
3. Muret gabion do te ndertohen ne vend duke marre rrjeta te gatshme teli te xinguar tipit kosh , me kapak, si dhe me shufra lidhese ne mes te rrjetes gjate mbushjes me gure.Guret te perzgjidhen ne lume me madhesi deri ne 30 cm-40 cm,duke u vendosur ne konturin perimetral te koshit te rregullta, dhe pa sforco, me qellim qe te lejoje , mbylljen e saj mbas mbushjes, ne menyre korrekte.
4. Koshat e telit te xinguar duhet te jene me permasa 200x100x100, ose 100x100x100, me rrjetezim telit te tyre jo me te madh se 100mm x100mm, dhe diameter te telit te rrjetes 3.8-4 mm, me $f_y=540-770\text{N/mm}^2$. Keto parametra, per muret gabion do te aplikohen vetem ne zonen e zhvillimit te rruges, mbi te cilen kalojne mjetet e transportit, dhe njerezit.



5. Per zonen e mbrojtjes brigjeve nga fenomeni I geryerjes, si zona me me pak ngarkese do te perdoren po te njejtat kosha 100x100x100 cm, me rrjetezim 100x100x100 mm, por me diameter te telit zingur te rrjetes prej 2.7-3 mm, por me te njejten cilesi materiali.
6. Materiali qe do te perdoret ne rrjetat per kosh duhet te jete 95% ZN, dhe 5% AL, material I cili siguron nje rezistence te larte , si shfrytezim ne kohe, duke mos u demtuar.



7. Shtresa mbikaluese prej betony te armuar te behen me beton C16/20, dhe te vendoset mbi shtresen e cakellit, betoni ,te kete klas ekspozimit XC2, me konsistence te rekomanduar S3 dhe me raport U/C ≤ 0.5 , dhe perberje materiali granulometrik jo me te madh se 20 mm, dhe sasi cimento jo me pak se 240 kg.
8. Hekuri qe do te perdoret ne armimin e shtreses rrugore parametrave teknike sipas eurocodit. Hekuri te jete klasa B me $f_y \geq 500\text{Mpa}$, Hekuri duhet te krijoje nje shtrese mbrojtese ne strukturen e shtreses mbikaluese prej betoni te armuar jo me pak se 3 cm , , duke e mbrojtur hekurin nga efekti korroziv ne kohe
9. Nderprerja e shtreses betonit (fugat), do te behet ne cdo 12m,zhvillim mbi murin gabion paralel me rrjedhen e lumit, (perpendicular me rrugen),duke vendosur ne fuga material rezistent nga veprimet e ndryshimit te temperaturave ne ambjent , ose me impluve llamarine xingato me trashesi jo me pak se 1mm. Ne fugat, duhet te jene te gjera jo me shume se 2-3 cm.E njejta gje duhet bere dhe per betonimin e mbi shtreses betonit mbi ure, gje e cila do te kete fuga ne zonen e mbeshtetjes se trareve, te saj.
10. Parapetet e betonit dhe trotualet , do te kene te njejta parametra si dhe mbishtresat rrugore per cilesine e betonit dhe hekurit, qe do te perdoret, si dhe fugat ne to.
11. Riparimi I kangjellave te ures ekzistuese, te behet ne menyre te tille qe Brenda cmimit te saj te pastrohen nga ndryshku, te lyhen me 2 duar boje antiruxho, si dhe atje ku ka nevoje si rezultat I demtimit te tyre te zevendoshen me profile te reja dhe ne zona e tjera te riparohen, shtohet sasia e tyre duke bere qe kjo paramet me structure metalike mos rrezikoje sidomos kalimin ne te te femijeve, te pa shoqeruar...
12. Per cdo paqartesi apo problem gjate zbatimit te thirren projektuesit e ketij projekti.

Ing. Albert Sharra